



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:083259

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05865587

P.nr.121/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshem, Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me pjesemarrjen e sekretares juridike Indira Beqa, në lëndën penale ndaj të pandehurit A.K nga fshati ..., Komuna Hani Elezit, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.639/21 të datës 30.04.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, më datë. 24.06.2024 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Dardan Qelaj, përfaqësueses së të dëmtuarës, M. S. dhe të pandehurit, më datë 27.06.2024 mori dhe shpalli, dhe të njejtën datë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A.K nga fsh....-Hani Elezit, i lindur më ... nga i ati S... dhe e ëma R..., e gjinisë L..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind I pesë fëmijeve, ka të kryer shkollën fillore, I pa punë, shfritëzues I pensionit të veteranit të luftës, i gjendjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri, me numër personal:

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 08.04.2021 rreth orës 18:00, në pyllin pronë publike në Hani Elezit, me të cilin menagjon APK–Hani Elezit, në rajonin ekonomik pyjor “Uji i bardhë”, në vendin e quajtur “Prroi i shkaftë”, i pandehuri me qëllim të vjedhjes së drunjve, ka prerë me sharrë motorikecopë drunj të llojit të bungut, me diametër 06-15 cm, dhe me lartësi 8 m, dhe me vëllim të përgjithshëm prej 16.24 m³, me ç ‘rast të dëmtuarës Autoriteti Pyjor Komunal në Hani Elezit i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 2078.70 euro.

Me këtë veprim i pandehuri ka kryer veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,48,69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 600.00 € (gjashtëqind euro), dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditësh, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i pandehuri në afat prej dy viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk do të kryejë vepër tjetër penale, në të kundërtën do t’i revokohet dënimi me kusht.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 30,00 € , ndërsa në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit në shumë prej 20.00€, të gjitha këto paguhen në afatin prej 30 ditësh, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

E dëmtuara APK-Hani Elezit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.639/21 të datës 30.04.2021 të pandehurin A.K nga fshati ..., Komuna Hani Elezit, e ka akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.18.01.2022, me të cilin rast i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Ne shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 24.06.2024, prokurori i shtetit nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, Dardan Qelaj, mbeti në tërësi pranë aktit akuzues të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotesime, duke i propozuar gjykatës që i pandehuri, të shpallet fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe t'i shqiptohet sanksion penal sipas ligjit.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës në fjalën e saj, I bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore juridike në vlerën si në aktakuzë.

I pandehuri A.K, në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale që i vëhet në barrë sipas aktit akuzues. Në mbrojtjen e tij ka theksuar se ditën kritike është e vërtetë që është takuar nga roja e pyllit R. C.dhe përgjegjësi E. Th., gjersa i njejtë ka qenë duke transportuar drunj me një traktor, të cilat i kishte prerë në pyllin prone publike në Hani Elezit pa qenë i pajisur me leje për prerje, mirëpo nuk është e vërtetë që ditën kritike kishte prerë sasinë drusore si në aktakuzë, por që kishte prerë rreth 120 copë drunj, për t'i shfrytëzuar për nevojat e ekonomisë familjare, meqë duke qenë shfrytëzues i pensionit të veteranit, ka qenë në kushte të dobëta ekonomike.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor prezantoi provat e propozuara me dëgjimin e dëshmitarëve: R. C., b. D. dhe E. Th., leximin e fletparaqitjes dhe procesverbalit për vlerësimin e dëmit me nr.32/21 të dt.23.04.2021 dhe shiqimin e fotografive të vendit të ngjarjes.

Pas prezantimit të provave dhe vlerësimit të tyre të plotë, secilën veç e veç dhe të gjitha në tërësi, mbrojtjes së të pandehurit si dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv.

Nga deklarata e dëshmitarit R.C, gjykata vërtetoi se, dëshmitari ka qenë duke punuar si roje pylli në kohën për të cilën bëhet fjalë në aktakuzë dhe ate në komunën e Hani Elezit, dhe ditën kritike duke qenë në detyrë zyrtare bashkë me përgjegjës në APK-E.Th rreth orës 18:00, e kishin e takuar të pandehurin A.K, në largësi prej rreth 10 metrave nga vendi I ngjarjes, i cili po drejtonte një traktor të ngarkuar me drunj, të prera me sharrë motorrike, dhe me te, pra me të pandehurin, ka qenë edhe djali I të pandehurit I moshës së re. Po nga kjo dëshmi Gjykata vërtetoi se meqë dëshmitari nuk e kishte me vete telefonin për të bërë fotografi, është kthyer te automjeti zyrtar për t'a marrë telefonin, derisa I pandehuri kishte lëvizuar dhe në afërsi të shtëpisë së tij kishte arritur që t'a fotografonte traktorin, siq shihet edhe në fotografitë e bashkangjitura në shkresat e lëndës. Përmes kësaj dëshmie Gjykata poashtu vërtetoi se drutë ishin prerë në pyllin pronë publike, në vendin e cekur si në dispozitiv dhe se në vendin e ngjarjes, pasi që kishte shkuar me përgjegjës në E.Th, kishte vërejtur se aty ka patur edhe shumë drunj të tjerë të prerë, dhe të lënë, dhe pasi që atë ditë ishte vonë, të nesërmen kishte dal në të njëjtin vend bashkë me kolegun e tij B.D për të bërë numërimin e trungjeve të prera, me të cilin rast ishte konstatuar se në vendin e ngjarjes janë prerë 580 copë drunj me shënime si në fletëparaqitje. Nga kjo dëshmi Gjykata vërtetoi se drutë të cilat I pandehuri I ka patur të ngarkuara në traktor nuk janë sekuestruar, por as drutë të cilat kanë qenë të prera në vendin e ngjarjes, të cilat poashtu I kishte marrë I pandehuri, dhe kjo për shkak të terrenit të vështirë për t'I tërhequr drunjët e prera.

Nga deklarata e dëshmitarit B.D, Gjykata vërtetoi se me dt.09.04.2021 në orët e paradites, kishte dal në teren, gjegjësisht në vendin e cekur si në aktakuzë, bashkë me kolegun e tij, R.C, dhe pasi që kanë dal në vendin e ngjarjes, me rastin e numërimit të trungjeve të prera, kanë konstatuar se në vendin e ngjarjes kanë qenë të prera me sharrë motorrike gjithsej 580 copë drunj, me shënime si në fletëparaqitje, për të cilat edhe kanë marrë shënime lidhur me diametrin dhe lartësinë. Po edhe nga kjo dëshmi, Gjykata vërtetoi se në vendin e ngjarjes ka patur edhe dru vetëm te prera dhe të lëna në vendin e ngjarjes, prerja e të cilave ka qenë e freskët dhe se të njëjtat nuk janë larguar nga vendi I ngjarjes.

Fakte të njëjta janë vërtetuar edhe nga deklarata e dëshmitarit E.Th, leximi i fletëparaqitjes dhe procesverbalit i vlerësimit të dëmit me nr.32/21 dhe shiqimi i fotografive të vendit të ngjarjes dhe atyre të traktorit të ngarkuar me drunj.

Gjykata u fali besimin këtyre dëshmimeve, meqë të njëjtat gjejnë mbështetje në njëra tjetrën dhe në provat materiale, të administruara, dhe pjesërisht edhe në mbrojtjen e të pandehurit, dhe sepse me të njëjtat në mënyrë të qartë dhe bindëse është përshkruar koha ,vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale.

Gjykata vlerësoi posaçërisht edhe mbrojtjen e të pandehurit, se I njejtë ditën kritike nuk I kishte prerë 580 copë drunj, por vetëm rreth 120 drunj, mirëpo të njëjtës gjykata nuk I fali besimin, meqë, bazuar në deklaratat e dëshmitarëve, nuk ka qenë dikush tjetër që ka prerë drunj në atë pjesë, dhe se ka qenë I pandehuri ai I cili I ka marrë të gjithë drunjët e prerë në vendin e ngjarjes, dhe poashtu Gjykata pati parasysh edhe faktin se I pandehuri derisa në prokurori kishte deklaruar se I kishte prerë rreth 300 copë drunj, në gjykatë deklaroi se I kishte prerë rreth 120 copë drunj. Prandaj, mbrojtjes së të pandehurit si të tillë në tërësi gjykata nuk mund t'i fal besimin, duke vlerësuar se qëllimi I tij është shmangia nga përgjegjësia penale për rastin në fjalë.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri, bazuar në evidencën e gjykatës nuk është përsëritës i veprave penale, apo edhe kundërvajtëse të kësaj natyre, gjendja jo e mirë ekonomike, si shfrytëzues i pensionit të veteranit të luftës, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti shkallën e lartë të dëmit të shkaktuar pyllit publik, të cilit i duhet një kohë relativisht e gjatë për t'u rivitalizuar.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin A.K, i akuzuar për veprën penale, , Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si ne dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore jurididike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P. nr. 121/21 datë 27.06.2024

Sekretarja juridike,
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.